



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për :	Sokol Haliti, Kryetar i Komunës së Vitisë Naim Pira, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë Departamenti Ligjor dhe i Monitorimit të Komunave/ MAPL
Përmes: PEP BARDHAM GECAS	Mirjana Jevtić, Ministre e MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së.
Nga:	Besim Myrtezani, U.D. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL
Lënda:	Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të komunës së Vitisë
Lloji i aktit:	Vendim

Datë: 04/04/2017
020/534

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësit Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi 01-013/364 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër, pronën e paluajtshme të komunës, Kompanisë KKDFE. SH.A. "KEDS" për vendosjen e një trafo elektrike
E miratuar më datë më datë: 29.03.2017
E parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 04.04.2017

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si me sipër, vlerëson se akti i komunës është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



ALBENIJA - OUTGOING
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration

Nr. 020-534/G
Date: 13.04.2017

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za:	Sokol Haliti, gradonačelnik opštine Vitina Naim Pira, predsedavajući Skupštine opštine Vitina	
Kopija:	Jedinica za upravljanje dokumentima u MALS-u Jedinica za upravljanje dokumentima u opštini Pravno odeljenje i monitorisanje opština, MALS	
Preko: <i>BAJRAM GECAJ</i>	Mirjana Jevtić, ministarka MALS-a Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka u MALS-u	
Od:	Besim Murtezani, v.d rukovodioca pravnog odeljenja i monitorisanje opština, MALS	Datum: 04/04/2017
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta opštine Vitina	020-534
Vrsta akta:	Odluka	

Poštovani gradonačelnice,
Poštovani predsedavajući,

U skladu sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje opštinskih akata i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za pravna pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka br. 01-013/364 za davanje na kratkotrajno korišćenje nepokretne opštinske imovine kompaniji KKDFE D.O. „KEDS“ za postavljanje trafostanica.
Usvojena dana: 29.03.2017.
Dostavljena MALS-u na razmatranje dana: 04.04.2017.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog opštinskog akta, procenjuje da je isti u saglasnosti sa zakonskim odredbama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvesti punopravni učinak. Ministarstvo administracije lokalne samouprave stoji na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republikof Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA

03-04-2017

01-013/364



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Vitia

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2, shkronja (d), neni 17 paragrafi 1 shkronja (c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40, (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008, në bazë të Nenit 7, paragrafi 3, Neni 10, paragrafi 1 pika 1.5 e Ligjit Nr.04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Neni 36, paragrafi 36.2, shkronja dtë Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, pas shqyrtimit të propozim vendimit të Kryetarit të Komunës me Nr. të Protokollit 02-013/29, të datës 13.01.2017, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në seance e mbajtur më datën 29.03.2017 nxerr këtë:

V E N D I M

Për Dhënien në Shfrytëzim Afatshkurtër, Pronën e Paluajtshme të Komunës, Kompanisë KKDFE SH.A. "KEDS" J.S.C për vendosjen e një trafo elektrike

Neni 1

1.Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë jep në shfrytëzim afatshkurtër prej 15 (pesëmbëdhjetë) viteve pronën e paluajtshme të Komunës së Vitisë Kompanisë KKDFE SH.A. "KEDS" J.S.C. Njësia në Viti.

1.1. Për vendosjen e një trafo elektrike në parcelat me nr.1540-2, me sipërfaqe prej 6m², në Zonën Kadastrale në Remnik, parcelat nr.1797-2, me sipërfaqe prej 9m², parcelën nr.3623-2 me sipërfaqe prej 20m², në zonën kadastrale në Viti, parcelën me nr 1327-2 me sipërfaqe prej 6m² në zonën kadastrale në Sadovoin të Çerkezve.

Neni 2

2.Parcelat kadastrale të sipërshënuar, që janë objekt të këtij vendimi, i jepet në shfrytëzim afatshkurtër, pa të drejtën e dhënies me qira, pa të drejtën e nën kontraktimit me personat e tretë, me mundësi të vazhdimit vetëm për destinacionin e përcaktuar me lartë dhe nuk mund të shfrytëzohet për qëllime tjera.

Neni 3

3.Paluejtshmëria e cekur në Neni 1 të këtij vendimi, i jepet në shfrytëzim afatshkurtër prej 15 (pesëmbëdhjetë) viteve, pa kompensim, Kompanisë KKDFE SH.A. "KEDS" J.S.C.

3.1.Njësia në Viti, për vendosjen e një trafo elektrike në parcelat me nr.1540-2, me sipërfaqe prej 6m², në Zonën Kadastrale në Remnik, parcelat nr.1797-2, me sipërfaqe prej 9 m², parcelën nr.3623-2 me sipërfaqe prej 20m² në zonën kadastrale në Viti, parcelën me nr 1327-2 me sipërfaqe prej 6m² në zonën kadastrale në Sadovoin e Çerkezve.

HYRËSE-ULAZNA-INCOMING REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO GENERAL E KOSOVES VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVO			
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministarstvo Lokalne Samouprave / Administracije Ministry of Local Government Administration			
Data Datumi: 04-04-2017 Date			
Njësia organizative -2-	Nr. i Lëndës 010-534	Shkrojtja	Vlera

Neni 4

4. Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë, obligohet të caktoj taksën ndaj kompanisë së lartcekur, bazuar në Rregulloren Komunale për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha.

Neni 5

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi dhe Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë dhe Zyra e Kryetarit të Komunës.

Neni 6

6. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal në kuptim të nenit 81, Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr 28/2008), nenit 8 të Rregullores Nr.01/2016, për shqyrtimin administrative të akteve të Komunave dhe pas publikimit në Web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Drejtorisë për Kadastër,
2. Drejtorisë për Shërbime Publike,
3. Shërbimit të Kuvendit, dhe
4. Arkivit .

**KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
KRYESUESI**

